VENDIM
Nr. 77, datë 22.4.2020

MBI KËRKESËN E ZYRTARIT TË PËRPUTHSHMËRISË SË "ALBGAZ" SHA, PËR SHTYRJEN E AFATIT TË DORËZIMIT TË "RAPORTIT VJETOR TË PËRPUTHSHMËRISË" TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 47, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar; të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, kreut VI, germa "C", pika 73, të "Programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 26.5.2017, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.4.2020, mbasi shqyrtoi informacionin e përgatitur nga Drejtoria Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi kërkesën e zyrtarit të përputhshmërisë së "Albgaz" sh.a., për shtyrjen e afatit të dorëzimit të raportit vjetor të përputhshmërisë",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 77, datë 26.5.2017, "Mbi miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror" ka vendosur të miratojë "Programin e përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror" (RCP).

- Në kreun VI, germa "C", pika 73, të këtij programi, përcaktohet si vijon: 1. Çdo vit, jo më vonë se data [31 mars], zyrtari i përputhshmërisë duhet të përgatisë dhe të dorëzojë në ERE një raport për përputhshmërinë e OST-së me këtë program, i cili duhet të publikohet në faqen e internetit të OST-së dhe të ERE-s.

- Me komunikimin elektronik të datës 8.4.2020, zyrtari i përputhshmërisë së "Albgaz" sh.a., ka bërë me dije se në kushtet kur, qeveria shqiptare, me anë të vendimit nr. 243, datë 24.3.2020, ka vendosur shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë, për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, si dhe pas masave të marra për kufizimin e lëvizjes, ka rezultuar i pamundur verifikimi i të dhënave, rishikimi i korrespondencave, si dhe përditësimi i informacionit për përfundimin e "Raportit vjetor të përputhshmërisë", për vitin 2019, për "Albgaz" sh.a.

- Duke marrë në konsideratë gjendjen e krijuar, për shkak të COVID-19 dhe kufizimet që janë vendosur, me qëllim parandalimin e përhapjes së këtij infeksioni, kërkesa e zyrtarit të përputhshmërisë për të shtyrë afatin e dërgimit të raportit vjetor deri jo më vonë se 1 muaj pas përfundimit të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, është e drejtë dhe në harmoni me vendimmarrjet e ERE-s nr. 51 datë 26.3.2020, si dhe nr. 67, datë 8.4.2020, mbi masat e përkohshme për trajtimin e çështjeve në kompetencë të ERE-s, pas përfundimit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pezullojë zbatimin e afatit të parashikuar në kreun VI, germa "C", pika 73, të "Programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 26.5.2017, deri jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë Zyrtarin e Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror, Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë, si dhe OST sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti